



REPUBLIKA E KOSOVËS – REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVA
KOMUNA JUNIK – OPŠTINA JUNIK- MUNICIPALITY OF JUNIK

Kuvendi i Komunës

Nr. 002/13/20

Datë: 05.06. 2020

Bazuar në Ligjin për Vetëqeverisje Lokale, (LVL) Nr. 03/L-040, neni 12, paragrafi 12.2, Statutit të Komunës së Junikut (të datës 29.9.2010), neni 21, paragrafi 21.1 pika j) Kuvendi Komunal në Junik në mbledhjen e rregullt të mbajtur me datë: 29.05.2020, mori këtë:

V E N D I M

për fillimin e hartimit të (projekt) Kodit të Etikës

- I. Me këtë vendim fillohet hartimi i (projekt) Kodit të Etikës / në tekstin e mëtejme (projekt) Kodi/.
- II. Qëllimi i nxjerrjes dhe miratimit të këtij (projekt) Kodi, sipas këtij vendimi është krijimi i bazës ligjore për fillimin e hartimit të Kodit të Etikës.
- III. Bartëse e (projekt) Kodit nga pika I e këtij Vendimi është Zyra e Kryetarit të Komunës së Junikut.
- IV. Bartësja e hartimit të (projekt) Rregullores është e obliguar që (projekt) Kodin ta hartoj në afat prej 6 muaj nga dita e hyrjes në fuqi të këtij vendimi.
- V. Autorizohet Kryetari i Komunës së Junikut që pas hyrjes në fuqi të këtij vendimi ta emëroj grupin punues për hartimin e (projekt) Kodit nga pika I e këtij Vendimi.
- VI. (projekt) Kodi duhet të vihet në shqyrtim publik. Paraqitja e (projekt) Kodit në shqyrtim publik dhe koha për dhënien e shqyrtimeve dhe komenteve do të shpallen në ueb faqen e Komunës së Junikut.
- VII. Pas hartimit (projekt) Kodi i procedohet kuvendit të komunës për shqyrtim dhe miratim.
- VIII. Mjetet financiare për hartimin e (projekt) Kodit sigurohen nga buxheti i Komunës së Junikut.
- IX. Me hyrjen në fuqi të këtij vendimi shfuqizohen të gjitha dispozitat ligjore me anë të të cilave kjo fushë ka qenë e rregulluar.

- X. Për zbatimin e këtij vendimi kujdeset Kryetari i Komunës respektivisht Zyra e Personelit.
- XI. Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit të ministrisë përgjegjëse për vetëqeverisje lokale, si dhe publikimit në gjuhen zyrtare në ueb faqen zyrtare të Komunës së Junikut

Me këtë vendim njoftohen:

- MAPL,
- Kryetari i komunës së Junikut
- Shërbimi i Kuvendit,
- Arkiva.

Kryesuesi i Kuvendit
z. Muhamed Krasniqi

